



Pranimi - Dorezimi Primenje - Prodato Kryerjen - Dorezimi	09.03.2022	2	viti god year
Organ Njësia Organ / Jedinstvo Org. Unit	Hr. Prot. Hr. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANDIHEK	1263/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.75/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.75/2022 të datës 31.01.2022 të parashtruar nga ankuesi

të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 09.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.75/2022 e datës 31.01.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar ne pozitën " Kordinator i njësisë për IT " sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012 në Drejtorinë e Administratës në Komunën e Pejës, me datën 02.03.2021 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Personelit në Komunën e Pejës, që ti bëhet ndryshimi i akt emërimit nga pozita "Kordinator" në pozitën "Udhëheqës i sektorit për teknologji informative" si dhe ndryshimin e koeficientit nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin shtatë pikë pesë (7.5).

Drejtori për administratë në Komunën e Pejës me datën 03.03.2021 përmes emalit ka kërkuar nga Burimet Njerëzore në Komunën e Pejës që të bëhet përmirësimi i aktit të emërimit ndërsa sa i përket koeficientit ka theksuar se është e pa realizueshme, për arsyeje se janë ndaluar rritjet e koeficientit me vendimin e qeverisë.

Ankuesi [redacted] me datë 22.10.2021 përmes emailit ka kërkuar nga Menaxheri i Personelit në komunën e Pejës që ti bëhet harmonizimi i koeficientit njëjtte me menaxheret e personelit të sektorëve të tjerë brenda komunës së Pejës, ndërsa me datën 01.11.2021 ankuesi përmes emailit i është drejtuar DMZP-se me kërkesë për informacion që aktualisht ankuesi ka koeficientin 6 ndërsa kryen punën e shefit të sektorit të TI-së.

DMZP-ja me datën 09.11.2021 i është përgjigjur ankuesit se është shqyrtuar kërkesa juaj lidhur me përshkrimin e detyrave të punës, strukturës së organizimit të Drejtorisë së Administratës për nivelizimin e pozitës së sektorit për IT me pozitat e tjera të udhëheqësve të sektorit në Komunën e Pejës duke e rekomanduar Drejtorin e Administratës të bëjë nivelizimin e pozitës së udhëheqësit të sektorit të TI-së me pozitat e tjera të udhëheqësve të sektorit në Komunën e Pejës.

Ankuesi me datën 28.01.2022 përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila me datën 31.01.2022 është pranuar në Këshill dhe ka numër të protokollit 409/2022, pretendimi i ankuesit në ankesë është që ti bëhet ngritja e koeficientit nga 6 në koeficientin 7.5 duke filluar nga muaji janar i vitit 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 03.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Pejës, ndërsa me datën 22.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.75/2022 me numër të protokollit 409/2022 të parashtruar nga ankuesi përmes emailit me datën 28.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.02.2022 me numër të protokollit 514/2022; Përgjigjen në ankesë të datës 22.02.2022 me numër të protokollit 933/2022; Akt emërimin e datës 09.01.2012 të ankuesit; Kërkesën e datës 02.03.2021 me numër të protokollit 02-016/01-21597; Kërkesën e datës 03.03.2021; Shkrese lidhur me administrimin e programit klasifikimit dhe organizimi planifikimi për vitin 2021 dhe 2022; Emalin e datës 22.10.2021; Emalin e datës 10.11.2021; Emalin e datës 01.11.2021; Emalin datës 24.02.2022; Kontratën e punës me numër 529 të datës 16.10.2009 të ankuesit; Akt emërimin e datës 01.01.2012; Konkursin e datës 28.01.2009; Diplomën me numër 680/12 të datës 22.06.2000; Raporti i komisionit përzgjedhës për vendin e punës menaxher i teknologjisë informative; Lajmërimi mbi pranimin në punë me numër 112-4583/2009 të datës 13.07.2009; Mirënjohjen e datës 21.06.2004; Mirënjohjen e datës 10.12.2008; Shkrese e datës 21.05.2009; Certificate lidhur me kryerjen e suksesshme të kursit themelore të oficerëve të akademi e mbrojtje 2004;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti bëhet ngritjen e koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë pikë pesë (7.5).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi themelimin e marrëdhënies së punës e ka në bazë të kontratës së punës të datës 16.10.2009 në pozitën "Koordinator i teknologjisë informative" e ka bërë me koeficient 6 saktësisht me pagën 214.50 euro, po ashtu në bazë të ndryshimit të Aktit të emërimit të datës 01.01.2012 për pozitën e ankuesit nuk është paraparë ndryshimi i koeficientit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se tek rasti i ankuesit nuk kemi asnjë akt administrativ nga Zyrtar më i Lartë Administrativ i Komunës me të cilën i është ngritur koeficienti, po ashtu nuk është dëshmuar me asnjë provë që komuna ka buxhet për realizimin e ngritjes së koeficientit, kështu që edhe pse Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Pejës ka bërë përpjekje duke kërkuar informacione nga DMZP-ja se si të veproj në rastin konkret, DMZP vetëm ka rekomanduar Drejtorin e Administratës për unifikim të koeficienteve, por siç është sqaruar më poshtë ekziston një procedurë që Komuna e Pejës duhet ta ndjek lidhur me këtë temë, ndërsa Kolegji nuk mund ta obligoj Komunën e Pejës për ndryshim të akt emërimit dhe koeficientit, sepse ankuesi ka qenë i vetëdijshëm që po nënshkruan akt emërim me koeficientin 6.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se neni 7 paragrafi 1 dhe 1 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton: "*Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për finançat*", rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja e koeficienteve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 përcakton se: "*Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës*" dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.75/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.